

# Udha e gjatë deri te liria

**Nuk më kujtohet t'u kem shërbyer ndonjëherë këtyre personave. Megjithëse, siç e dini, kamerieri gjatë shërbimit më shumë duhet të kujdest për atë që bart se sa të shohë ata të cilët shërben. Duke shikuar ndonjë çikë të mirë, më ka rastisur t'i thej filxhanat dhe ta bëj helaq edhe ndonjë klient...**

## Tregim në tri pjesë

Në njërin prej ditëve të fundit të pranverës së vitit 1971, në Bahnhofin e Bernës zbritën edhe dy djem që vinin nga një vend krejt i harruar me emrin Kosovë.

Njëri syresh ishte i hollë, me flokë të gjatë e ngjyrë gështenjë. Ende nuk i kishte mbushur njëzet vjet. Nga sytë i shkëlqente një blertimë, si uji i burimit nën hijen e shelgut.

Posa zbritën në peron po i thotë bashkudhëtarit: hapi sytë se n'vend të huaj merr n'thu më lehtë, por rrëzohesh më keq.

Ai tjetri, që ishte krejt i hutuar e pyeti: kah me shku na tash?

Drejt, kah po shkojnë të tjerët dhe mos u huto se nuk është bërë hataja që kemi ardhur këtu. Sepse n'katund temin stacioni i trenit është shumë më i madh se ky këtu dhe ndërtesat më të lartat për një disa kate.

- Shuj more zhelan se po t'ndien kush!

- A di çka? A ulemi dhe ta marrim nga një kafe, se po më duket se jemi lodhur pak.

- U ulen në bistrion Rapid në ndërtesën e Stacionit. Kur erdhi kamerieri i drejtua në gjermanisht se çka dëshironin.

- Një bucelë me qumësht të dhisë!

- Nicht fertich.

- Kafe sade!

- Ja Kafel!

- Sade.

- Nain sade, ja kafe.

- Ua solli kafetë.

- Pas pak nga prapa banakut drejt tyre u drejtua një i ri:

- Mirëdita, prej nga jeni?

- Nga Perlepnica

Nga Pograxha e Gjilanit

- Unë jam nga Kaçaniku... Po punoj në këtë bistro. Po ju, çka ju ka qitur puna?

- Erdhëm edhe na me pa dynja me sy, tha flokëgjati.

- Çka dini me punu, tha kaçanikasi.

- Unë ndërtojë aeroplana, ndërsa ky, shoku im është usta i madh për trena, tha flokëgjati.

- E di se shqiptari i di dhe punon të gjitha, por unë e kam pa hajgare.

- Kemi dalur jashtë për të gjetur ndonjë punë verës, përndryshe kemi qëlluar të dy pa asnjë zanat.

- Po flas me padronin dhe besoj se mund të gjeni punë këtu, njëri në kuzhinë dhe tjetri në servis. Shkoj dhe erdhi me padronin.

Si e ke emrin

Zijah Shemsiu, u përgjigj flokëgjati  
Sa vjet i ke?

20.

Po ti?

Naim...

Të nesërmen ia filluan punës. Në fillim ishte vështirë, por pasi i theu disa gota dhe mori disa hungërimë në gjermanisht, u mësua.

Gjuhën e mësoi shpejt dhe pa u bërë 3 muaj komunikonte si zviceran dhe shërbente si të kishte mbaruar shkollën e turizmit.

Kishte një dilemë a të shkonte në Kosovë të regjistrohej në studime apo ç'të bënte. I pëlqente të ishte i pavarur, të fitonte vetë bukën e gojës. Gradualisht u mësua edhe me ritmin e punës.

Fitonte një rrogë solide, ndihmonte shtëpinë, udhëtonte te shokët dhe te të afërmit në Zvicër e Gjermani gjithnjë me një hare të pashqitshme.

Pas disa vitesh u njoh me Gertën, një bernuaze shumë simpatike. Ajo admironte humorin e tij dhe qasjen e drejtpërdrejtë ndaj hallevë të përditshme të jetës, ndërsa ai atë sjelljen e saj lirshëm dhe komunikimin pa asnjë kompleks...

Jetonin bashkë. Pas disa muajsh u lindi një djalë.

Një ditë shkoi ta vazhdojë pasaportën në Amasadë. E dorëzoi dhe i thanë të vijë të nesërmen. Kur shkoi e futën në një zyrë, në katën e parë. Aty e priti një burrë rreth dyzetvjeçar që iu paraqit si Marko.

- Ti je Zijahu?

- Po.

- Ti punon në Rapid,

- Po.

- Ka kohë që kam pasur dëshirë të bisedojmë.

- Po ju dëgjoj, tha, ndërkohë që iu kujtua se e kishte parë atë fytyrë shpeshherë andej, kah Bahnhofi.

- Unë jam konsulli, merrem më shumë me problemet që i kanë zemljakët tanë. Kam dëgjuar se ti je shef i servisit në Rapid dhe shfaqja dëshirën të bisedojmë pak për do gjëra të rëndësishme... Andej nëpër Bahnhof kalojnë plot njerëz.

- Po për atë punë është bahnhofi. Vazhdimisht udhëtojnë e zbresin njerëzit, ia ktheu me një indiferencë të plotë.

- ... na kemi armiq..., emigracioni është i rrezikshëm, ata po dërgojnë në Jugosllavi bomba, po edhe libra armiqësore, po bëjnë propagandë... ne si qytetar e kemi për

detyrë ta mbrojmë vendin nga rrënuesit e ndryshëm... Ne kemi nevojë që nëse ti sheh ndonjë njeri të rrezikshëm të na telefonosh menjëherë. Ja për shembull a të kanë rënë në sy ndonjëherë ndonjëri prej këtyre personave? Këta sillen shpesh këndej.

Dhe i vuri në tavolinë 4 fotografi.

Dy i njohu menjëherë, ishin gazetarë të rinj, njëri bashkëfshatar, ndërsa tjetri gjilanas. Flitej se askush nuk e di se ku ndodhen prej vitesh. Dy të tjerët nuk i njohte.

U përmbajt dhe tha i krejt qetë:

- Nuk më kujtohet t'u kem shërbyer ndonjëherë këtyre personave. Megjithëse, siç e dini, kamerieri gjatë shërbimit më shumë duhet të kujdest për atë që bart se sa të shohë ata të cilët shërben. Duke shikuar ndonjë çikë të mirë, më ka rastisur t'i thej filxhanat dhe ta bëj helaq edhe ndonjë klient...

- Sidoqoftë nëse i sheh ndonjëherë lajmërohu. Mos harro se në këto hesape bakshishi është shumë më i madh se në Rapid.

Do ta kem parasysht... Në dorë i mbeti kartëvizita e konsullit.

Dhe doli. Ishte mars i vitit 1980.

Pas tri javësh në Rapid hyri një person fytyra e të cilët i dukej shumë e njohur.

E, pa me vëmendje, por nuk i kujtohej. I gjasonte me fotografinë që kishte parë në zyrën e konsullit. Por paskësh ndryshuar shumë; i kishin rënë flokët dhe rrethi i syve iu kish thelluar si të kishte boksuar tërë ditën. Iu afrua duke i thënë shqip:

- Mirëdita!

- Tungatjeta.

- Si je Kadri?

- Mirë si je ti?!

- Ndoshta nuk po më njeh. Jam Zijah Shemsiu, nga Perlepnica dhe kam diçka të rëndësishme me të thënë. Por këtu mund të biem në sy.

I shërbeu një kafe dhe në të një letër ku i tregoi shkurt se duhej të bisedonin, por jo këtu. I dha telefonin në shtëpi.

Pas tri ditësh u takuan në Movenpic. I tregoi si ishte puna dhe i tha se sa herë që të ketë nevojë për të të mos ngurrojë.

U takuan edhe disa herë të tjera.

Një ditë fundjave, gjersa me të shoqen po shkonte në Thun, për piknik, pa një person me një borsoline e me frak që mbante një qen për dore, një nga ata minukët e vegjël që rriten me lezet në banesa. Iu duk fytyrë shumë e njohur.

E pa me vëmendje. Kishte qenë Selim



**Do t'i blem shkurt. Atje në Zvicër nuk më ke kuptuar mirë, ndoshta këtu më merr vesh më mirë: I ke dy rrugë, ose do të bësh çka të themi ne ose nesër në mëngjes kemi për të sjellë këtu në burg bashkë me ty krejt familjen dhe do t'i dënojmë njësoj si ty që po mbush Kosovën me material propagandistik dhe me armë!**

Brosha!

A po më bëjnë sytë apo çka drejtin është në pyetje? Iu afrua edhe më afër dhe u bind se ishte ai, udbashi i njohur i Gjilanit. U bë se nuk po e njeh: pastaj iu përvodh ngadalë për ta përcjellë se çka bënte ai aty, i maskuar në frak, me kravatë flutur dhe me një qen të vogël race për dore. Iu përvodh anash dhe pas pak e pa se ai po bisedonte me një femër, asistente refugjatësh, të cilën e njihje, sepse shkonte shpesh në Rapid.

U çudit.

Pas katër ditësh takoi Kadri Zekën. I tregoi për Broshën dhe i tha të ketë kujdes. Më 11 mars 1981, në lajmet e mesnatës u njoftua për trazirat e studentëve në Prishtinë. Ditët e pastajme vinin lajme për gjendjen e tendosur, për vazhdimin e trazirave. Për herë të parë në jetën e tij filloi të mendojë politikisht.

Në takimin tjetër me Kadriun, i tha se duhet bërë diçka.

- Mos më heto në këtë mënyrë, jemi bashkëvendas, jam i gatshëm me ba çka të më thuhet.

Tërë atë pranverë i vizitoi gjithë të njohurit e tij në Bernë e rrethinë.

U fliste për demonstratat në Prishtinë e gjetkë. U telefononte njerëzve që i njihje.

Ishte një gjendje e tendosur, te të gjithë që bisedonte shihte një brengë, një shqetësim, një revoltë të çuditshme. Të gjithë ata njerëz, që nuk i kishte dëgjuar kurrë të flasin për politikë, tani ishin elektrizuar, flasin me urrejtje për shtetin jugosllav dhe ma admirim për studentët.

Ata njerëz që dërrmoheshin në punë, që kursenin aq shumë, tash ishin bërë krejt të tjerë. Çuditej me ta dhe me vetveten.

Më 11 prill 1981, në Bernë organizuan demonstratën e parë, ku morrën pjesë mbi 300 veta. Disa burra të moshuar u bënë gati si të shkonin në luftë. I doli shumë problem me nja dy bashkatdhetarë të moshuar të rrethit të Ferizajt, të cilët këmbëngulnin t'i marrin revolet me vete: ndoshta duhet të vrite mi me shkiqe, thonin.

Kaluan mirë. Një gazetari serb ia morrën aparatit. Ndërsa një tjetri, sigurisht punëtor i ambasadës në Bernë, që fotografonte nga korridori i një ndërtese ia shkundën pluhurin bukur mirë.

U angazhua në hapjen e klubeve shqiptare. Nuk ka bashkëpunim me serbë, ne duhet t'i bëjmë klubet tona, ne duhet të punojmë që t'i kemi të gjitha tonat: edhe pasaportat tona, ne duhet të bëhemi me të gjitha më vete dhe për vete.

Tashmë ishte tretur përgjithnjë jeta normale, fundjavët e qeta me të shoqen dhe djalin. Duhej udhëtuar nga demonstrata në demonstratë, duhej të futeshin njerëzit nga një

kufi në tjetrin, duhej shpërndarë shtypi i lirë, duhej dhënë anëtarësia...

Kjo krijoi të çarat e para në familje. Ku ke qenë, pse s'po vjen me kohë... Ishte i lodhur, nuk kishte kohë as për sqarime, i dukej absurde të sqarohet. Një ditë e humbi edhe punën.

Atentati, në Shtutgart, kur u vranë tre prijës të Lëvizjes, e dërrmoi shpirtërisht.

Në një mbrëmje kur po e torturonte vetmia, kur pa se lëvizja mbeti pa udhëheqje dhe po shkapërderdhej organizimi, preku fundin me gruan:

Në pyetjet e saj ku ke qenë (kishte qenë në varrimin e njerëzve që po t'i thoshin zhvishu dhe shtrihu në prush, do t'i dëgjonte pa kundërshtin) nuk mundi të përmbahet. Ia tha shkurt: ti nuk e di dhe nuk do ta marrësh vesh kurrë se çka është dhimbja, se çka është vuajtja dhe me një njeri që nuk i merr vesh këto gjëra e kam të pamundur ta çojë jetën.

I mori teshat dhe doli. Nuk e puthi as të birin. E dinte se po ngutej, por ishte i vrarë

dhe kishte nevojë për një ngushëllim, për një fjalë të mirë.

Atë natë shkoi te S. Basha, i cili posa ia hapi derën e pa se ishte shumë keq. Në pyetjen se çka kishte, i tha shkurt:

"Kurrë dheu i huej dhe njerëzit e huej nuk mund të bëhen tutë... edhe po qe se duan. Tash shtromë se kam nevojë t'i pushoj eshtrat dhe trutë."

Të nesërmen e mori veten. Shkoj dhe gjeti punë në Gumlingen, e mori në telefon të shoqen dhe i tha shkurt: Nuk desha të të fyej mbrëmë. Nuk është edhe faji yt. E di se dhimbja e dheut tim e dërrmon edhe shkëmbin e lëre më martesën tonë. Nuk është e drejtë që ajo peshë të përplasat edhe mbi ty. Të kuptoj. Ne do të mbetemi përgjithmonë miq, por bashkëshortësia jonë ka marrë fund.

Në anën tjetër të telefonit dëgjoheshin dënësat...

...Natën e mirë.



Dhe jeta e lufta vazhdonin. Organizoheshin demonstrata, shpërndaheshin gazetata, mbledheshin mjetet financiare për organizatën. Nisnin përçarjet. Në një rën prej këtyre aktiviteteve u njoh me Nuhiun, student i arratisur. Ishte dhjetë vjet më i ri, një djalë si rrufeja. Rrinin gjatë dhe bisedonin për të gjitha. Një ditë vendosën të shkojnë "brenda". U përgatitën, i blenë hartat topografike, morën nga një armë dhe pasi morën rreth 1000 kopje të shtypit të lirë, u futën në Kosovë.

Nuk ishte puna keq. U kthye prapë, shkoi prapë, u kthye dhe shkoi sërish me Salihun. Atje takoi Nuhiun, takoi edhe Rexhepin, që posa ishte liruar nga burgu. U frymëzua me forcën dhe vullnetin e tyre. Në vjeshtën e parë të vitit '83 shkoi me një student tjetër të arratisur, S. K. Një ditë para se të nisej takoi një gazetar të Kosovës, mikun e një shokut të tij. E lanë të takohen në Prishtinë, caktuan datën dhe vendin. Nuk ishte i vetmi me të cilin kishte folur. Prandaj nuk vonoi e nisën të dalin fjalët nëpër Bernë për udhëtimet e tij të çuditshme...

Kaluan Italinë, hynë në Sloveni, aty morën, si zakonisht, autobusin Lubljanë-Beograd. Ishte krejt i qetë.

Diku afër Beogradit policia ndali autobusin, dukej si një kontroll i zakonshëm. Hyri njëri syresh dhe u tha dorëzoni dokumentet, udhëtarët i jepnin, njëri-pas tjetrit. Doli problemi me një udhëtar në karrigat e para dhe urdhëruan shoferin ta dërgojë autobusin në stacion të policisë.

Filluan të zbresin një nga një. Para tij ishte Studenti, zbriti me qetësi të



## Banhofi

**Nuk më kujtohet t'u kem shërbyer ndonjëherë këtyre personave. Megjithëse, siç e dini, kamerieri gjatë shërbimit më shumë duhet të kujdest për atë që bart se sa të shohë ata të cilët shërben. Duke shikuar ndonjë çikë të mirë, më ka rastisur t'i thej fibxhanat dhe ta bëj helaq edhe ndonjë klient...**

jashtëzakonshme.

Vetë kishte armën më vete, një revolver smith wesson, ngjitur te çorapja. Si pahetushëm u përpoq ta nxjerrë ngadalë, por me t'u kërrusur, dy "udhëtarë" që ishin pas tij iu sulën përmbi.

Ishte e pamundur të bënte çkado qoftë. U bind se kanë rënë në kurth dhe se krejt kjo ka qenë vetëm një sajese. Ia shtrënguan duart si me darë dhe e zbritën posht. Më tej ishte Studenti i lidhur.

Mbahej shumë mirë.

Ku e ke bagazhin?

Nuk kam.

Ku po shkon,

Në shtëpi.

Grushti i parë pse nuk po tregon se ku është bagazhi...

Pastaj në një "maricë" dhe drejt në objektin, që më vonë do të mësojë se quhet Burgu Qendror (Centralni zatvor, CZ).

E çuan në një zyrë. Aty e prit një befasi tjetër: Në tavolinë përballë ishte Marko, konsulli jugosllav në Bernë!

U çua në këmbë posa e futën brenda:

- Po ku je mor, Shemsiu ti? Ç'ka të ka nxjerrë puna në Beograd? E sheh, më mirë të shihemi në Zvicër apo këtu te ne, në prestonicë.

- ?!

- Do t'i biem shkurt. Atje në Zvicër nuk më ke kuptuar mirë, ndoshta këtu më merr vesh më mirë: I ke dy rrugë, ose do të bësh çka të themi ne ose nesër në mëngjes kemi për të sjellë këtu në burg bashkë me ty krejt familjen dhe do t'i dënojmë njësoj si ty që po mbush Kosovën me material propagandistik dhe me armë!

Edhe pse i vetëdijshëm se ishte zënë me kërpesh për dore dhe se ishte i tëri në kurth, iu përgjigj me vendosmëri:

- Unë do të bëj vetëm atë që më urdhëron ndërgjegjja ime.

- Paç veten më qafë.

Dhe pas pak hyn brenda xhelatçinjtë. Iu hodhën sipër me shqelma, me dajakë e me boksa. Kishte përshtypjen se është kokërr elbi nën gurin e mullirit.

Mezi arrinte të merrte frymë.

Dikur humbi vetëdijen, pastaj e sillnin në vete me ujë dhe prapë "procedura e mullirit"...

Pas dy ditësh ia sollën babain. E kishin dërrmuar. U përpoqën ta detyrojnë të ndikojë te i biri, por Plaku vetëm i tha:

- Biro, nuk është me rëndësi kur del, por si del prej këtu.

I ranë Plakut keq sa që iu përgjak goja prej nga i ra një dhemb në tokë, si të ishte fasule. U vërsul mbi kriminelin dhe i ra me kokë në gjoks. E hodhi përdhe. U lëshuan mbi të gjersa humbi vetëdijen.

Një ditë ia sollën Studentin në ballafaqim. E kishin shkallmuar, e njohu vetëm në sajë të setrës, sepse koka i ishte bërë dy herë më e madhe. Sytë iu kishin mbyllur.

E pyetën a e njeh. Ai përgjigjej jo me pëhatje koke, sepse si duket nuk mund të

fliste.

E pyetën edhe këtë a e njeh ti Sami Kurteshin?

- Sot po e shoh për herë të parë!

E torturuan tërë natën sa që në mëngjes e çuan deri te qelia duke e tërhequr për këmbësh zvarrë nëpër korridor.

Pastaj ia sollën të dy vëllezërit dhe kështu me muaj: vëllezërit, Plakun, Studentin.

Në mënyrë veçanërisht mizore sillëshin



edhe dy shqipfolës që vinin për ta marrë në pyetje, njëri nga Gjilani ndërsa tjetri nga Vranja.

U bë dhe gjykimi, ishte maji i vitit 1984. E dënuan më 13 vjet burg, Studenti më 9 vjet burg, të dy vëllezërit më nga 5 vjet burg, ndërsa Plakun 4 vjet.

Më 5 mars 1985, bashkë me të burgosur të tjerë politikë hartoi dhe nënshkroi një Memorandum drejtuar organeve të Federatës, në të cilin arsyetoheshin kërkesat e Lëvizjes për Republikë. Pas këtij Memorandumi i shpërndanë e i bënë pikë e pesë nëpër burgje të ndryshme.

Më 1 maj 1985 e nxorën nga qelia dhe e dërguan në një zyrë. Aty kishte qenë Marko.

- Ku je, si je Shemsiu? Ti akoma nuk ke vënë mend. Çka po të duhen peticionet, pse nuk po shikon punën tënde, e sheh se ke shkatërruar familjen tënde. Ju ka mbe-tur shtëpia në gra e në fëmijë...

Vetëm e pa drejt e në sy. I shkoi mendja t'i përgjigjet, por mendoi se më mirë është ta sfidojë me heshtje.

- Të kam thirrë prapë, për të tretën herë, me t'hanë se nëse do të më dëgjosh, unë jam në gjendje brenda dy javësh me ta lëshue edhe babain edhe vëllezërit. Ti duhet të më dëgjosh... Ne e kemi shkatërruar Lëvizjen jashtë, ne i kemi përçarë në mes veti e i kemi bërë pikë e pesë. A e di ti se "Zërin e Kosovës" që e ke sjellë këtu, duke rrezikuar kokën, ne e kemi bërë paçavër. Tani po del një zë tjetër i Kosovës, në të po shkrueh çka është një e zezë për shokët e tu... do të dalin prapë zëra të Kosovës, pra ne ia kemi arritur qëllimit. (Zijai shte në dijeni për çarjet e

mëdha që kishin ndodhur pas arrestimit të tij, ia kishte thënë një i burgosur tjetër). Ne e kemi vrrarë Jusufin e Kadriun, Bardhin, Nuhiun, Rexhepin. Kemi vrrarë edhe të tjerë, do të vrasim prapë. E ke kot, ne i dimë të gjitha, por një gjë po na mungon në mozaik, një detaj krejt i vogël.

Vendosi të heshtë gjer në fund dhe vetëm ta dëgjojë me vëmendje.

- Kemi të dhëna se me një rast ke qenë në

Barcelonë, atje je takuar me dikë, kush ka qenë ai, kush ta ka dhënë lidhjen dhe çfarë kombësie ka pasur dhe për çka keni biseduar.

E kishte lodhur vetmia, druante se kjo thikë mund t'i vinte herë-dokur një ditë, i përqëndroi forcat e fundit për ta ruajtur gjakftohtësinë. Por ishte vështirë, sepse njeriu që kishte përpara ishte pipthi konkret i merimangës, që ia kishte mbështjellë mjeshhtërisht trupin, jetën, familjen, shokët, kombin dhe i përpinte të gjithë ngadalë e për qejf. E pushtoi një tërbim, një urrejtje sa që ishte i gatshëm ta hante të gjallë.

- Fol, pse po hesht. E ke në dorë veten dhe familjen tënde.

- Unë vetëm ndërgjegjen time e kam në dorë, asgjë tjetër. Këto që po i thua nuk po i marrë vesh. Unë jam i dënuar, ndaj meje nuk

ka më hetime...

- Hetimet për ty kanë për të vazhduar edhe kur të mos dihet se ku e ke pasur varrin.

- Unë nuk kam çka them më.

Marko u çua, iu afrua krejt afër dhe i ra shuplakë sa që ia humbi krejt drejtpeshimin. Pastaj ia shau nënën dhe djepin që e ka rritur, ia shau farën.

I erdhi te hunda. Krahas urrejtjes një ide për kotësinë dhe pakuptimësinë e jetës në burg, kur nuk i shërben çështjes, kur mund të të keqtrajtojë kush të dojë... Pafuqia për t'i ikur shfëtitimit të kriminelëve, pamundësia për t'ua ndaluar t'ia shajnë Nënë, motrën, farën... Ishte bërë shumë dhe tani gërmomin atje ku nuk guxonte ta shihte as në ëndërr...

Ishte vetëm të dy. Trutë ia ndriçoi një vetëtimë: paska ardhur ora e vdekjes, ora e shpëtimit; dhe iu vërsul me thonj e me dhëmbë. Përleshja zgjati derisa erdhën e u bënë shumë. Zgjati deri sa ua la shpirtin në duar.

Pas dy ditësh njoftuan familjen me telegram se ka vdekur nga një sëmundje në fyt.

Pastaj e sollën kufomën. E varrosën në varrezat e fshatit. Shumë ditë me rradhë varrezat i ruante policia

Por zogjve, çuditërisht, askush nuk mundi t'ua ndalë këngën atë verë. Vetëm ata ia përcillnin grumbullit të ri të dheut mallin e dhimbjen e pafund të shokëve të tij.

Atyre, shokëve, që kur u binte ndërmend Ai, e kjo ndodhte e vazhdon të ndodhë shpesh, iu ndalej fryma e u tretaj edhe ndonjë rreze e rrallë e gëzimit.

**Xhafer Shatri**